

TË DHËNAT PËR NDOTJEN E MJEDISIT FUQIZOJNË VEPRIMIN KOMUNITAR

Udhëzues për organizatat e shoqërisë civile në Kosovë për përdorimin e informacionit në Regjistrat e Shkarkimit dhe të Transferimit të Ndotjes

transfer

Përgatitja e këtij materiali u mbështet nga projekti "*Enhancement of Pollutant Release and Transfer Registers (PRTRs) in the Western Balkan Countries and the Republic of Moldova*", i cili u financua nga Ministria Federale Gjermane e Mjedisit me fonde nga Programi i Asistencës Këshillimore (AAP) për mbrojtjen e mjedisit në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, Kaukazit dhe Azisë Qendrore si dhe vende të tjera në kufi me Bashkimin Evropian. Ai u mbikëqyr nga Agjencia Gjermane e Mjedisit (UBA) dhe u zbatua nga Participatio Ltd. në partneritet me EcoContact, REC Albania, REC BiH dhe REC Mali i Zi.

Kontribuan në përgatitjen e materialit:

Afrim Berisha

Shkipe Deda

(c) Qendra Burimore e Mjedisit në Shqipëri, 2024

Materiale dhe pjesë të botimi mund të përdoren duke cituar burimin nga janë marrë

Përmbajtje

1. Hyrje 5

2. Kuadri ligjor i Kosovës për RSHTN 8

3. Informacioni i raportuar në RSHTN 11

4. Shoqëria civile dhe RSHTN 13

5. Hapësira dhe mundësia që krijon RShTN për qasjen në informimin dhe pjesëmarrjen e publikut në politikat mjedisore 17

6. Burimet e informacionit 26

Shkurtime

AMMK	Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
E-RSHTN	Rregullorja Evropiane për Shkarkimin dhe Transferimin e Ndotësve
EU/BE	Bashkimi Evropian
IED	Direktiva e Emetimeve Industriale
HCFCs	bonet hidroklorofluorokare
MMPHI	Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
LCP/IMD	Impiantet e Mëdha me Djegie
NMVOCs	Përbërjet Organike të Paqëndrueshme jo-metan
PAHs	Hidrokarburet aromatike policiklike
PM10	Grimcat e pluhurit deri në 10 mikron
POP/NOQ	Ndotës Organikë të Qëndrueshëm
RSHTN	Regjistrat e Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve
TOC	Karboni Organik Total
PFCs	Perfluorokarbonet

1. Hyrje

Gjatë dekadave të fundit, regjistrat e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve (RSHTN) janë shëndërruar në një mjet të ri dhe të rëndësishëm në fushën e menaxhimit të kimikateve. Duke sjellë informacion mbi emetimet ndotëse në mjediset publike, RSHTN-të rrisin ndërgjegjësimin për burimet kryesore të kërcënimit ndaj shëndetit dhe mjedisit dhe i mundësojnë publikut të luajë një rol më efektiv për të ndikuar në proceset vendimmarrëse që lidhen me këto kërcënime. Rritja e transparencë mund të krijojë presion mbi kompanitë për të reduktuar barrën e ndotjes që rrjedh nga aktivitetet e tyre.

Protokolli i Kievit për RSHTN është i pari instrument ligjor i detyrueshëm ndërkombëtarisht mbi këtë temë, duke i angazhuar palët e saj për të krijuar RSHTN-të që janë të qasshme për publikun dhe mirëmbahen përmes raportimit të detyrueshëm të një grupi të gjerë ndotësish nga disa aktivitete të rëndësishme mjedisore.

Kjo broshurë prezanton konceptin e RSHTN-së, tregon historinë se si Protokolli hyri në fuqi dhe përshkruan kërkesat e tij kryesore dhe aktivitetet që po ndërmerren për të nxitur zbatimin e tij.

Çfarë është një RSHTN?

RSHTN është një Regjistër i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve, i njohur shkurt si RSHTN. Ai është një regjistër i qasshëm për publikisht që përmban informacion mbi shkarkimet (emetimet) nga operatorët në mjedisi, dhe transferimet e tyre, dhe që përfshinë një grup të caktuar ndotësish nga disa aktivitetete specifike. Informacioni i përfshirë në një RSHTN raportohet në mënyrë periodike, zakonisht në baza vjetore dhe është i detyrueshme, nga operatorët përgjegjëse për aktivitetet që shkaktojnë shkarkimet dhe transferimet. RSHTN duhet të jetë i qasshëm nëpërmjet internetit dhe i disponueshëm sipas operatorit individual, pronarit/kompanisë, llojit të ndotësit, llojit të aktivitetit dhe mjedisit përkatës (ajri, uji, toka).

1.1 Çfarë duhet të raportohet?

RSHTN duhet të mbulojë informacionin për të paktën 86 ndotës ose grupe ndotësish që njihen si kërcënimet më të rëndësishme për mjedisin dhe shëndetin, duke përfshirë gazet kryesore serë, ndotësit që shkaktojnë shiun acidik, metalet e rënda, pesticidet e rrezikshme dhe kimikatet kancerogjene sikurse janë dioksinat. Ndotësit e përfshirë në kuadër të Protokolli mbi RSHTN-të janë renditur në Aneksin II të Protokollit, i cili përmban të gjithë ndotësit organikë të qëndrueshëm (POP) të inventarizuar në bazë të Konventës së Stokholmit për Pollutantët Organikë Qëndrueshëm.

Protokolli identifikon një seri grupesh të rëndësishme substancash, të tilla si karboni organik total (TOC), komponimet organike të halogjenizuara, fenolet, grimcat (PM10),

dioksinat, hidrokarburet aromatike policiklike (PAHs), cianidet, fluoridet, përbërjet organike të paqëndrueshme jo-metan (NMVOCs), perfluorokarbonet (PFCs), bonet hidroklorofluorokare (HCFCs), si dhe ndotësit kryesorë individualë. Këto grupe mbulojnë potencialisht mijëra substanca të ndryshme[1].

Regjistrat kombëtarë ofrojnë gjithashtu një kornizë për raportimin mbi ndotjen nga burime të hapura si trafiku, bujqësia, akuakultura dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Këtu, Protokolli lejon disa fleksibilitet, ku Palëve u kërkohet të përfshijnë vetëm të dhëna për shkarkimet nga burime të hapura në RSHTN që janë mbledhur nga autoritetet përkatëse dhe që praktikisht mund të përfshihen në regjistër. Megjithatë, kur të dhënat e tilla nuk mundë të mblidhen, Palët duhet të marrin masa për të filluar raportimin për shkarkimet nga një ose më shumë burime të hapura.



Figura 1: Raportimi nga operatorët në kuadër të RSHTN

Theksi i Protokollit dhe i RSHTN-ve në përgjithësi është në sasinë e ndotjes së shkarkuar ose të transferuar. Ai, nuk merr parasysh ndikimin e ndotësve në mjedis ose shëndet (p.sh., nëse ndotësit shkarkohen në një zonë të ndjeshme mjedisore ose në një lokacion me popullsi të dendur). Ai gjithashtu nuk identifikon kohën e saktë të shkarkimit brenda vitit raportues. Këto veçori e bëjnë RSHTN-në një instrument të thjeshtë por efektiv, i cili duhet të përdoret së bashku me të tjerët instrumente për të dhënë efektin e dëshirueshëm.

Shumë nga substancat e përfshira në Protokoll janë të kufizuara ashpër, janë të ndaluara ose janë duke u larguar nga përdorimi gradualisht përmes marrëveshjeve

[1] *Your Right to a Healthy Community, A simplified guide to the Protocol on Pollutant Release and Transfer Registers, UN 2011 (http://www.unece.org/env/pp/prtr.htm)*

ndërkombëtare. Ato përfshihen në Protokoll për hir të plotësisë dhe për të ndihmuar vendet që të gjurmojnë mbetjet e ndotësve për ti larguar gradualisht ato.

Koncepti i "shkarkimeve" në përgjithësi kuptohet për të mbuluar situatat ku ndotësit emetohen ose futen në mjedis nga një operator (subjekt ekonomik) ose burime të tjera.

Koncepti i "transferimeve" zbatohet për lëvizjen e ndotësve brenda ose ndërmjet operatorëve. Protokolli mbulon vetëm transferimet "jashtë lokacionit përkatës". Lëvizjet e ndotësve ose mbetjeve ndërmjet dy instalimeve të të njëjtit operator në të njëjtin vend ose zona fqinje konsiderohen si një transferim në vend dhe nuk janë subjekt i raportimit sipas Protokollit.

Raportimi nuk kërkohet kur janë në pyetje sasitë e ndotësit që bie nën pragje të caktuara, të cilat janë të specifikuara në Aneksin II të Protokollit. Në terma të gjerë, ekzistojnë dy lloje të pragut, njëri i bazuar mbi sasinë e ndotësit të shkarkuar ose të transferuar, dhe tjetri i bazuar në mbi sasinë e ndotësit të prodhuar, të përpunuar ose të përdorur. Nëse Pala zgjedhë të përdorë llojin e pragut të parë, atëherë duhet të bëjë një zgjedhje të mëtejshme ndërmjet raportimit specifik të ndotësve të transferuar dhe raportimit specifik te mbetjeve të transferuara. Nëse Pala zgjedh qasjen specifike të raportimit të ndotësve, duhet të kërkojë nga operatorët për të raportuar kur pragjet individuale për substancat kimike (ato të renditura në aneksin II të Protokollit) të transferuara janë tejkaluar gjatë vitit raportues. Nëse Pala zgjedh qasjen specifike të mbetjeve, ajo duhet të kërkojë nga operatorët që të raportojnë atëherë kur janë tejkaluar kufijtë për vëllimin e përgjithshëm të mbetjeve gjatë vitit raportues. Sipas qasjes së fundit, pragu vendoset në 2000 ton për mbetjet jo të rrezikshme dhe 2 ton për mbetjet e rrezikshme. Nëse destinacioni i mbetjeve të rrezikshme është ndërkufitar, d.m.th mbetjet po eksportohen në një vend tjetër, Protokolli kërkon që Pala të mbledh nga pronari ose operatori informacion mbi destinacionin aktual të mbetjeve dhe mënyra e asgjësimit ose rikuperimit të tyre[2].

Informacioni i mbledhur sipas Protokollit mbi lëvizjen ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme mbështet objektivat e Konventës së Bazelit për Kontrollin e Lëvizjeve Ndërkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme dhe asgjësimin e tyre. Ndërsa fakti që Protokolli lejon metoda të ndryshme raportimi, siç u përmbledh më lart, e shton kompleksitetin e tij dhe potencialisht zvogëlon krahasueshmërinë e të dhënave të raportuara. Opsionet e ndryshme të raportimit u përfshinë nga negociatorët në njohje të faktit se tashmë sistemet e krijuara të RSHTN-së reflektuan qasje të ndryshme dhe me qëllim që këto qasje të ndryshme të akomodohen brenda Protokollit. Në përgjithësi, RSHTN-të evropiane përdorin llojin e parë të pragut, ndërsa disa nga RSHTN-të e Amerikës Veriore përdorin llojin e dytë të pragut.

[2] *Your Right to a Healthy Community, A simplified guide to the Protocol on Pollutant Release and Transfer Registers, UN 2011 (http://www.unece.org/env/pp/prtr.htm)*

2. Kuadri ligjor i Kosovës për RSHTN

Kosova ende nuk e ka ratifikuar Prokollin e Kievit për RSHTN, meqenëse nuk është anëtare e OKB-së dhe e UNECE. Kështu që Kosova ende nuk e ka të specifikuar legjislacionin e saj konform kërkesavë të Protokollit të Kievit. Kërkesat e reja të E-Raportimeve u kërkojnë Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian që për Impiantet e Mëdha me Djegie (IMD), sipas Direktivës së Emetimeve Industriale (IED)[3] dhe Impianteve, dhe sipas Rregullores Evropiane për Shkarkimin dhe Transferimin e Ndotësve (E-RSHTN)[4], të raportojnë në mënyrë të integruar, duk ju referuar si "Rrjedha e të dhënave E-RSHTN+IMD". Ky model i ri për rrjedhën e të dhënave E-RSHTN+IMD është rezultat i përpjekjeve për të përmirësuar raportimin mbi emetimet industriale. Rrjedha e të dhënave E-PRTR+LCP është projektuar posaçërisht për të funksionuar paralelisht me të dhënat për Regjistrin e BE-së për Lokacionet Industriale[5].

Në kuadër të procesit të integrimeve evropiane, Kosova ka bërë disa hapa në kuadër të përmbushjes së kërkesave të Rregullores për E-RSHTN[6]. Në mënyrë të pjesshme kërkesat e RSHTN janë të prezantuara në Ligjin nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit Neni 53, dhe në Udhëzimin Administrativ nr. 17/2023 për Kadastrin e Shkarkimeve Ndotësve në Mjedis, edhe pse terminoligjia e përdorur më shumë i referohet termit "Kadastër" se sa "Regjistër". Në mënyrë indirekte kërkesat e RSHTN, janë të përfshira edhe në Ligjin 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Ligjin nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, Ligjin 04/L-060 për Mbeturina, Ligjin 04/L-197 për Kemikate dhe në Ligjin 08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes.

Aktualisht Kosova është në proces të hartimit të Ligjit të ri për Mbrojtjen e Mjedisit, ku pritet të adresohen në mënyrë specifike obligimet për raportim për E-RSHTN+IMD, sipas Direktivës së Emetimeve Industriale (IED) dhe Impianteve, dhe sipas Rregullores Evropiane për Shkarkimin dhe Transferimin e Ndotësve (E-RSHTN).

2.1 Cilët operatorë duhet të raportojnë të dhënat në RSHTN në Kosovë?

Në Kosovë operatorët që në të ardhem duhet të raportojnë të dhënat në RSHTN janë ata që do të bien në kategoritë e industrive përkatëse të listuara në Shtojcën I të Rregullores E-RSHTN, sikurse janë: energjia, prodhimi dhe përpunimi i metaleve, industria minerare, industria kimike, menaxhimi i mbetjeve dhe ujërave te zeza, prodhimi dhe përpunimi i letrës dhe drurit, prodhimi intensiv blegtoral dhe akuakultura, prodhimet shtazore dhe bimore nga sektori i ushqimit dhe pijeve dhe aktivitete të tjera, që janë të pajisura me Leje të Integruara Mjedisore dhe që kapaciteti i tyre i tejkalon pragjet e përcaktuara sipas rregullores E-RSHTN.

---

[3] *Direktiva 2010/75/EU*
[4] *Rregullorja (EC) Nr. 166/2006*
[5] *E-PRTR and LCP integrated reporting, Data model documentation, EEA 2011*
[6] *Rregullorja (KE) Nr. 166/2006 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, date 18.02.2006 "Për ngritjen e Regjistrit Evropian të Shkarkimeve dhe Transferimit të Ndotësve dhe amendimin e Direktivës së Këshillit Nr. 91/689/KEE dhe 96/61/KE*



Figura 2: Termocentralet e Korporatës Energjetike të Kosovës, janë subjekt tipik i RSHTN

Operatorët që duhet të raportojnë të dhënat në RSHTN në Kosovë, po ashtu duhet të emetojnë shkarkimet në ajer, ujë dhe tokë si dhe transferimet jashtë objektit në ujrat e zeza të ndonjë prej 91 ndotësve që tejkalojnë vlerat e pragut të specifikuar për atë klasë në Shtojcën II të Rregullores E-RSHTN, transferimet jashtë objektit të mbetjeve të rrezikshme që tejkalojnë 2 ton në vit apo të mbetjeve jo të rrezikshme që tejkalojnë 2,000 ton në vit.

2.2 Kush raporton dhe cilat janë afatet kohore?

Raportimi vjetor i detyrueshëm kërkohet në lidhje me një gamë të gjerë aktivitetesh. Këto përfshijnë rafineritë, termocentralet, prodhimi dhe përpunimi i metaleve, industritë kimike dhe minerare, inceneratorët e mbetjeve, impiantet e trajtimit të ujërave të zeza, prodhimi dhe përpunimi i drurit dhe letrës, ndërtimi i anijeve, fermat e kafshëve, prodhimi i perimeve si dhe bujqësia dhe akuakultura intensive. Gjithsej mbulohen 64 aktivitete të grupuara sipas sektorëve. Pronari ose operatori i një veprimtarie që kryen një ose më shumë nga këto aktivitete është përgjegjës për dërgimin e raportit.

Aktivitetet brenda sektorëve të mbuluar nga Protokolli nuk kërkohet të raportojnë nëse ata janë në një shkallë të vogël dhe nën kufijtë e përcaktuar. Ashtu si me pragjet e ndotësve, ekzistojnë dy lloje të pragut të aktivitetit.

- **Pragu i parë** i aktivitetit bazohet në kapacitetin e objektit, p.sh., numri i megavateve, tonelatat e materialit të përpunuar në orë etj.
- **Pragu i dytë** bazohet në numrin e punonjësve, dhe aktivitetet me shumë punonjës bien në kërkesën për të raportuar.

Zgjedhja e llojit të pragut të aktivitetit shoqërohet me zgjedhjen e pragut të ndotësve, në mënyrë të tillë që një Palë që aplikon një prag të ndotësve bazuar në sasinë e ndotësit të shkarkuar ose të transferuar duhet të zbatojë përgjithësisht një prag aktiviteti bazuar në kapacitetin e objektit. Ndërsa një Palë që zgjedh një prag ndotësish bazuar në sasinë e ndotësit të prodhuar, përpunuar ose përdorur duhet në përgjithësi të zbatojë një prag aktiviteti bazuar në numrin e punonjësve.

Protokolli kërkon që pas ciklit të parë të raportimit, informacioni për një vit të caktuar kalendarik të përfshihet në regjistrin kombëtar brenda 5 muajve nga fundi i atij viti. (Organizatat rajonale të integrimit ekonomik sikur është BE-ja kanë gjashtë muaj shtesë). I lihet secilës Palë të përcaktojë afatet e brendshme kohore sipas të cilave operatorët individual duhet t'i dorëzojnë autoritetit kompetent të dhënat që përfshihen përfundimisht në regjistër.

2.3 Kujt i raportohet të dhënat?

Çdo Palë pritet të caktojë një autoritet ose autoritete kompetente për të menaxhuar RSHTN-në kombëtare. Palët duhet të krijojë një kuadër ligjor kombëtar i cili përcakton detyrimet e autoriteteve administrative që do të mbledhin, vërtetojnë dhe menaxhojnë regjistrin, si dhe do të merren me qasjen e të dhënave dhe çështjet e konfidencialitetit.

Në vendet që tashmë kanë sisteme të raportimit të ndotësve, dy strukturat më të zakonshme në përdorim për mbledhjen e të dhënave të nevojshme për krijimin e regjistrave kombëtarë të emetimeve janë:

(a) kërkesat e informacionit të përcaktuara në lejet mjedisore;
(b) vetë-monitorimi dhe raportimi i detyrueshëm.

Në rastin e Kosovës **autoriteti kombëtar për krijimin e kuadër ligjor kombëtar,** i cili përcakton detyrimet e autoriteteve administrative që do të mbledhin, vërtetojnë dhe menaxhojnë regjistrin, është **Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)**.

Ndërsa **autoriteti kompetente për të menaxhuar RSHTN-në** kombëtare**,** qasjen e të dhënave, çështjet e konfidencialitetit dhe raportimin e të dhënave është **Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK).**

Shumë vende, dhe sidomos ato në Evropën Perëndimore, kanë tashmë sisteme të zhvilluara mirë për lejimin e instalimeve të mëdha industriale, duke përfshirë vetë-monitorimin e detyrueshëm dhe raportimin e emetimeve ndotëse.

Për të shmangur dyfishimin e përpjekjeve, ata e kanë lidhur mbledhjen e të dhënave të kërkuara për RSHTN-të e tyre kombëtare me kërkesat tashmë të vendosura në sistemin e tyre të lejeve. Vetë Protokolli nxit Palët të integrojnë sistemet e RSHTN në

mekanizma të tjerë raportues për aq sa është e mundur, në mënyrë që të reduktohet raportimi i dyfishtë.



Figura 3: Rrjedha e të dhënave për RSHTN

3. Informacioni i raportuar në RSHTN

Protokolli parashikon qasjen elektronike të drejtpërdrejtë përmes rrjeteve publike të telekomunikacionit, siç është një faqe e hapur në internet, si mjeti kryesor i qasjes në informata për publikun. Në këtë rast, RSHTN duhet të jetë i qasshëm pa pagesë. Kjo formë qasjes në të dhëna ka shumë përparësi.

RSHTN mund të qaset nga kushdo që ka aftësi për përdorimin e kompjuterit në çdo kohë dhe nga çdo vend dhe që ka një lidhje të mirë interneti në dispozicion. Mjetet elektronike mund të përdoren për të kërkuar dhe analizuar të dhënat.

Në rastin e Kosovës qasja e drejtpërdrejtë në të dhënat e RSHTN ofrohet përmes portalit www.rshtn.rks-gov.net që menaxhohet dhe mirëmbahet nga Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK).

Megjithatë, Protokolli pranon se jo të gjithë kanë qasje të lehtë në internet, dhe për këtë arsye kërkon që palët të ofrojnë "mjete të tjera efektive" për grupet e publikut që nuk kanë qasje të drejtpërdrejtë elektronike në RSHTN. Kjo mund të përfshijë ofrimin e qasjes elektronik në RSHTN në vende publike si bibliotekat ose zyrat e autoriteteve publike, ose ofrimin e kopjeve të të dhënave në formë letre ose CD-ROM. Kur kopjet e të dhënave të RSHTN-së ofrohen sipas kërkesës, Protokolli kërkon që kjo të bëhet brenda një muaji nga data kur është parashtruar kërkesa. Autoriteti kompetent mund të vendosë një tarifë për riprodhimin dhe postimin e informacionit, me kusht që kjo të mos kalojë një shumë të arsyeshme.

A janë të gjitha informacionet e hapura për publikun?

Protokolli përcakton rrethana të kufizuara në të cilat një autoritet kompetent mund të mbajë konfidenciale të dhënat e RSHTN-së, p.sh., kur zbulimi publik do të ndikonte negativisht në marrëdhëniet ndërkombëtare, mbrojtjen kombëtare, sigurinë publike ose konfidencialitetin tregtar. Në raste të tilla, arsyet për konfidencialitetin duhet të interpretohen "në mënyrë të kufizuar", duke marrë parasysh interesin e publikut që i ofrohet informacioni i zbuluar dhe nëse informacioni lidhet me shkarkimet në mjedis. Kur informacioni është mbajtur në fshehtësi, regjistri duhet të tregojë llojin e informacionit që është mbajtur në fshehtësi dhe arsyen(et) e mbajtjes së tij në fshehtësi.

3.1 Për çfarë mund të përdoret informacioni nga RSHTN?

RSHTN-të kanë për qëllim kryesisht t'i shërbejnë publikut të gjerë, por ato gjithashtu ndihmojnë qeverinë në përcjelljen e tendencave të ndotjes, përcaktimin e prioriteteve dhe monitorimin e pajtueshmërisë me angazhimet ndërkombëtare. Përveç kësaj, nga informacioni i RSHTN-së mund të përfitojnë industrinë, si menaxhmenti ashtu edhe punëtorët, përmes stimulimit të përmirësimit të menaxhimit të mjedisit brenda operatorëve.

Edhe **mediat** gjithashtu mund të përdorin të dhënat e RSHTN-së për të publikuar çështjet e ndotjes, duke i bërë të dhënat të disponueshme dhe të kuptueshme për një audiencë më të gjerë.



Ka shumë përdorues të mundshëm të RSHTN-ve. Këta përfshijnë, para së gjithash, publikun e gjerë dhe organizatat e shoqërisë civile të interesuar për të marrë informacion mbi ndotjen lokale, rajonale ose kombëtare. Pastaj, **profesionistët shëndetësorë** të cilët mund ta përdorin informacionin në vendimet që adresojnë çështjet e shëndetit publik.

RSHTN-të mund të jenë një mjet i vlefshëm për **edukimin mjedisor**. Autoritetet mjedisore mund të përdorin RSHTN-të për të rishikuar përputhshmërinë e objekteve lokale me kushtet e lejeve të tyre, si dhe progresin kombëtar drejt angazhimeve ndërkombëtare, sikurse është për shembull progresi për përmbushjen e kërkesave të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Për operatorët, zbatimi i monitorimit ose vlerësimi i niveleve të ndotjes, si dhe publikimi i detyrueshëm i të dhënave, mund të nxisë përpjekjet për të përmirësuar efikasitetin dhe për të ulur nivelet e ndotjes.

4. Shoqëria civile dhe RSHTN

4.1 Roli dhe pjesëmarrja e shoqerisë civile në vendimmarrjen mjedisore

Shoqëria civile ka një rol shumë të rëndësishëm në vendimmarrjen dhe monitorimin mjedisor, duke siguruar që politikat dhe masat mjedisore të jenë të drejta dhe të përputhshme me nevojat dhe kërkesat e komunitetit.

Përmes pjesëmarrjes në procesin e vendimmarrjes, shoqërisë civile i sigurohet e drejta e kontrollit dhe monitorimit të aktiviteteve dhe veprimtarive të organeve lokale dhe qendrore në çështjet që ndikojnë në jetën e tyre në kuptimin publik, ekonomik, social, shëndetësor dhe mjedisor, si dhe një interaksion i mirëfilltë me institucionet në procesin e zhvillimit të planeve, programeve, dhe draftimit të politikave mjedisore.

Regjistri i Shkarkimit dhe të Transferimit të Ndotësve, anglisht: Pollutant Release and Transfer Register (PRTR), është instrument i dobishëm në përmirësimin e transparencës dhe pjesëmarrjes publike në çështjet mjedisore. Përmes këtij instrumenti, qytetarët dhe shoqëria civile mund të kenë casje të drejtpërdrejtë në informacionin mbi ndotjen dhe ndikimin mjedisor të aktiviteteve industriale. Kjo ndihmon në rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe lehtëson kontrollin dhe monitorimin e veprimtarive të organeve lokale dhe qendrore.

Roli i shoqërisë civile në vendimmarrje dhe monitorim për çështjet mjedisore:

- T'i monitorojë nivelet e ndotjes së mjedisit dhe të raportojë për ndotjen te autoritetet relevante. Kjo mund të bëhet përmes hulumtimeve vetanake si dhe në të ardhmen përmes përdorimit të të dhënave të PRTR.

- Të advokojë për politika mjedisore të mira duke ndërhyrë në procesin e vendimmarrjes dhe duke mbrojtur interesat e publikut në lidhje me mjedisin.

- Të jetë pjesëmarrëse aktive në konsultimet publike për politikat dhe projektet mjedisore, si dhe draftimin e ligjeve, për të siguruar që zërat e shoqërisë të dëgjohen në procesin e vendimmarrjes.

- Të monitorojë zbatimin e ligjeve dhe politikave mjedisore dhe të bëjë presion për zbatimin e tyre të drejtë.

- Të angazhohet në ndërgjegjësim dhe edukim të publikut për çështjet mjedisore dhe të promovojë sjellje dhe praktika të qëndrueshme në mjedis.

Pjesëmarrja e shoqërisë civile në vendimmarrje mjedisore dhe monitorimin të zbatimit në Kosovë është e rëndësishme për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit në vend. Organizatat e shoqërisë civile luajnë një rol kritik në parandalimin e aktiviteteve potencialisht të rrezikshme, në mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e trajtimit të drejtë dhe të qëndrueshëm të resurseve natyrore.

4.2 E drejta për qasje në informim, sipas Konventës së Aarhusit

Qëllimi kryesor i Konventës së Aarhusit për Qasjen në Informacion, Pjesëmarrjen Publike në Vendimmarrje dhe Qasjen në Drejtësi në Çështjet Mjedisore është të kontribuojë në mbrojtjen e të drejtës së secilit që i takon gjeneratës së tashme, por edhe të ardhme, për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe me mirëqenie për ta. Konventa fuqizon rolin e qytetarëve dhe organizatave shoqërore në çështjet mjedisore dhe është themeluar mbi parimet e demokracisë pjesëmarrëse.

Konventa e mban të përgjegjshme çdo palë relevante që ta garantojë të drejtën e publikut për të pasur informacion mbi mjedisin, për të qenë pjesëmarrës aktiv në marrjen e vendimeve mjedisore dhe për t'ju drejtuar gjykatës në lidhje me çështjet mjedisore në përputhje me klauzolat e kësaj Konvente.

Si akt normativ me karakter ndërkombëtar, Konventa e Aarhus-it vendos një numër të drejtash për publikun (qytetarët dhe asociacionet e tyre) në lidhje me mjedisin. Autoritetet publike, në nivel kombëtar, rajonal ose lokal, duhet të kontribuojnë që këto të drejta të mos mbeten vetëm në rrafshin teorik por të bëhen efektive duke u zbatuar në praktikë.

Konventa përcakton të drejtën e secilit që të ketë qasje në informatat mjedisore që maten dhe regjistrohen nga autoritetet publike. Kjo përfshinë informacionet mbi gjendjen e mjedisit, por edhe mbi politikat dhe masat e ndërmarra, ose mbi gjendjen shëndetësore të njerëzve dhe rreziqet të cilëve u ekspozohen nga gjendja e mjedisit. Qytetarëve iu garantohet e drejta e qasjes në informacionin e kërkuar brenda një muaji pas paraqitjes së kërkesës, pa qenë të detyruar t'i japin arsyet se pse e kërkojnë atë informacion. Për më tepër, autoritetet publike, sipas Konventës, janë të përgjegjshme t'ua ofrojnë qytetarëve informacionin mjedisor që e posedojnë ("qasja në informacionin mjedisor").

Megjithëse Kosova ende nuk është nënshkruese e Konventës së Aarhusit, parimet e kësaj konvente janë të integruara në Kushtetutë dhe legjislacionin vendas dhe sigurojnë të drejtën e publikut për të marrë informacion dhe për të qenë pjesëmarrës në vendimmarrje për çështjet mjedisore në vendin ku jetojnë. Kjo përfshinë të drejtën për të marrë informacion nga autoritetet publike, përfshirë informacionin në lidhje me emetimin e ndotësve nga burimet e caktuara.

4.3 Kuadri ligjor për të drejtën e informimit dhe pjesëmarrjen e publikut

Qytetarët e Kosovës kanë të drejta nga legjislacioni në fuqi për qasje në informacione mjedisore nga institucionet publike, përfshirë të dhëna mbi nivelin e ndotjes.

Ligji për Qasje në Dokumente Zyrtare me NR. 06/L-081 është instrument vital juridik për të siguruar të drejtën e qytetarëve Kosovar për informim të drejtë. Ky ligj definon

parimet, kushtet dhe kufizimet në bazë të interesave publike apo private që kanë të bëjnë me qasjen e publikut në dokumentet e organeve publike.

Duke e pasur parasysh se ky ligji është i gjerë dhe gjithëpërfshirës, ai mund të shërbejë edhe për realizimin e të drejtave të publikut që ndërlidhen legjislacionit mjedisor, respektivisht që kanë të bëjnë me qasjen në informata mjedisore. Praktikisht, secili që interesohet për çështjet mjedisore mund të kërkojë informacion nga nga autoritetet relevante të dhe ta pranojë atë në formë të shkruar apo verbale. Kësisoj, ligji NR. 06/L-081 praktikisht e siguron edhe të drejtën e publikut për qasje ndaj nformatave rreth politikave, vendimeve dhe programeve mjedisore.

Ligji për Qasje në Dokumente Zyrtare i garanton çdo parashtruesi të kërkesës zyrtare të ketë qasje në të gjitha dokumentet të cilat janë në posedim të institucioneve publike në çfarëdo forme. Përgjigja duhet të jepet brenda shtatë ditëve kalendarike. Në rastet kur institucionet nuk përgjigjen në kërkesat për qasje në dokumente publike apo përgjigjet e tyre nuk janë konform ligjit, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të dërgojë ankesë tek Avokati i Popullit apo të dorëzojë padi në gjykatën kompetente.

Kërkesa për qasje në dokumente publike[7] mund të bëhet përmes linkut: https://kerkoqasje.com/kerko-qasje-pavarura/ me formën e mëposhtme:

I/E nderuar,

Ligji Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike e garanton të drejtën e secilit person, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje në dokumentet publike, të prodhuara, pranuara, mbajtura apo kontrolluara nga institucionet publike.

Bazuar në nenin 10 të Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, që përcakton se secili person ka të drejtë për qasje në dokumente publike në bazë të kërkesës, kërkoj nga institucioni juaj që brenda afatit ligjor për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, të përcaktuar në nenin 12 të po të njëjtit ligj, të më ofroni qasje në:

1.

2.

Besoj që institucioni juaj do t'i përgjigjet kërkesës sime për realizimin e një të drejte kushtetuese dhe ligjore.

Me respekt,

Emri juaj këtu, (nëse dëshironi ta bëni të ditur)

[7] Edhe për të dhënat e PRTR-së mund të përdoret i njëjti format, por duhet të theksohet një referencë për dispozitën në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit ose Dekretin për Kadastrin e Ndotësve të Mjedisit, i cili është aktualisht në fuqi.

Në nivel lokal, pjesëmarrja e publikut dhe shoqërisë civile në vendimmarrje dhe politikëbërje, si dhe qasjen në informacionin përkatës, garantohet me Ligjin për Vetëqeverisje lokale NR. 03/L-040. Ky ligj e obligon çdo komunë që të mbajë së paku dy herë në vit takime publike në të cilat mund të marrë pjesë secili person apo organizatë. Në këto takime, pjesëmarrësit mund të shtrojnë pyetje dhe të japin propozime për përfaqësuesit e zgjedhur komunal. Qytetarët mund të marrin iniciativë për të propozuar rregullore brenda kompetencave të komunës për miratim nga kuvendi.

Gjithashtu, ligjet e Kosovës në fushën e mjedisit përcaktojnë përgjegjësitë dhe të drejtat e institucioneve publike dhe shoqërisë civile në lidhje me informacionin mjedisor. Këto dokumente ofrojnë udhëzime për të siguruar që publiku dhe shoqëria civile mund të kenë qasje të lehtë në informacion mjedisor.

Në vijim, Ligji për Mbrojtje të Mjedisit NR. 03/L-025 garanton se publiku ka të drejtë për qasje në regjistra ose evidenca që përmbajnë informata dhe të dhëna në përputhje me ligjin. Për shembull, gjithashtu, qasje në PRTR. Neni 54 rregullon qasjen në informata mbi gjendjen e mjedisit dhe dukuritë e monitorimit të emetimeve dhe gjendjes së mjedisit, si dhe mbi masat paralajmëruese ose të shtrirjes së ndotjes që mund të paraqesin rrezik për mjedisin, shëndetin dhe jetën e njeriut. Ministria, institucionet qendrore, komunat, organizatat e autorizuara dhe të autoritetet e tjera relevante janë të detyruara të informojnë publikun rregullisht, në mënyrë të plotë dhe objektive, dhe në përputhje me ligjin.

Ligji për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes NR. 08/L-145, (2023) në Nenin 25 e rregullon qasjen në informata dhe pjesëmarrjen e publikut në procedurat për dhënien e lejeve për impiantet e reja, ndryshimet thelbësore në leje mjedisore, si dhe për përditësimet e lejeve për impiantet ekzistuese në përputhje me nenin 20. Ministria siguron që publikut të interesuar i ofrohet mundësia për të marrë pjesë në këto procedura, dhe në uebfaqen zyrtare publikon informatat mbi masat e ndërmarra nga operatori pas mbylljes së veprimtarive në përputhje me nenin 22, si dhe rezultatet e monitorimit të emisioneve të kërkuara në kushtet e lejes të lëshuara nga Ministria.

Për më tepër, ky ligj me shtojcën e veçantë (Nr. 4), përcakton pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje, duke specifikuar se publiku duhet të informohet për fillimin e procedurës për marrjen e vendimeve duke përfshirë aplikimin për leje mjedisore, vlerësimin e ndikimit në mjedis, dhe detajet e autoriteteve kompetente. Ministria duhet të sigurojë që informacioni për raportet kryesore dhe këshillat e lëshuara është në dispozicion për publikun. Publiku i interesuar ka të drejtë të shprehë komentet dhe opinionet para se të merret çfarëdo vendimi, dhe rezultatet e konsultimeve duhet të merren parasysh gjatë marrjes së vendimeve. Aranzhimet për informimin dhe konsultimin e publikut duhet të përcaktohen nga autoriteti relevant duke siguruar afate kohore të arsyeshme për të informuar dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje në mënyrë efektive.

5. Hapësira dhe mundësia që krijon RShTN për qasjen në informimin dhe pjesëmarrjen e publikut në politikat mjedisore

Traktati i njohur si UNECE Protokolli për Regjistrat e Shkarkimit dhe të Transferimit të Ndotësve (PRTR) rrjedh nga Konventa e Aarhusit të vitit 1998 për Qasjen në Informacion, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje dhe Qasjen në Drejtësi në Çështjet Mjedisore.8. Ky Protokoll është një instrument që synon të rrisë transparencën në emetimin e ndotësve të caktuara në mjedis, bazur në raportimin nga operatorët. PRTR është burim i rëndësishëm i informacionit për organizatat jofitimprurëse dhe publikun që siguron transparencë për të monitoruar nivelet e ndotjes nga operatorët e caktuar. Kjo ndihmon shoqërinë civile në të dhëna për ndotjen e mjedisit dhe shërben si bazë për avokimin mjedisor dhe presion ndaj operatorëve për zvogëlim të emetimeve, si dhe në autoritetet për të zhvilluar dhe zbatuar programe ose politika për parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes.

Qasja në informacion është një element kyç për të lehtësuar pjesëmarrjen e shoqërisë civile në proceset e vendimmarrjes. Konventa e Aarhusit kërkon nga palët e saj të sigurojnë "informacion mjedisor" për publikun në kërkesë, përveç nëse zbatohen përjashtime të qarta, si dhe të mbajnë dhe të shpërndajnë aktivisht informacion mjedisor. Qasja në informacion është e lidhur drejtpërdrejt me vendimmarrjen e informuar dhe duhet të jetë e zbatueshme përmes procedurave ligjore të rishikimit. Po ashtu, Protokolli për PRTR kërkon nga palët të vendosin një regjistër të qasshëm publik për shkarkimin e ndotësve në ajër, ujë dhe tokë, si dhe transferin e mbeturinave të parrezikshme dhe atyre të rrezikshme. Qasja e publikut në informata duhet të garantohet, ndërsa konfidencialiteti kufizohet në përjashtime të qarta të përcaktuara mirë, dhe informacioni mbi emetimet që është relevant për mbrojtjen e mjedisit duhet të bëhet gjithmonë i njohur. Po ashtu, kur konsiderohen përjashtimet, autoriteti publik duhet të interpretojë pretendimin për konfidencialitet në mënyrë të kufizuar, duke marrë në konsideratë interesin publik të shërbyer nga zbulimi i informacionit, dhe nëse informacioni i kërkuar lidhet me emetimet në mjedis. Disa nga kriteret e rëndësishme për qasjen efektive në informata janë që kërkesat duhet të jenë pa pagesë ose të mos kushtojnë më shumë se një shumë e arsyeshme, dhe kërkesat për informacion duhet të përpunohen shpejt. Konventa e përcakton një limit kohor maksimal prej një muaji ose, në raste të rralla, dy muaj për kërkesat që lidhen me një numër të madh dokumentesh. Në rastet kur një kërkesë për informacion refuzohet, duhet të jepen arsye të mjaftueshme për refuzimin e dhënies së informatës. Kjo gjithashtu e lehtëson rishikimin e mundshëm nga autoritetet administrative të gjykatës për refuzimin në fjalë gjatë një faze të mëvonshme.

Protokolli për PRTR ka kërkesa të ngjashme në Nenet 11 të tij për Qasjen në Informacion, duke siguruar qasjen publike në informacionin e përmbajtur në PRTR. Kjo përfshinë përcaktimin e obligimeve për të siguruar qasjen në informacionin

[8] Konventa e miratuar në qershor 1998, përfshinte tashmë një detyrim për secilën Palë që „të ndërmarrë hapa për të krijuar gradualisht, një sistem të qëndrueshëm, në shkallë kombëtare të inventarëve ose regjistrave të ndotjes në një bazë të dhënash të strukturuar, të kompjuterizuar dhe të aksesueshme publikisht të përpiluar përmes raportimit të standardizuar", por nuk përmban detaje se si të zbatohet kjo.

mjedisore, duke përfshirë informacionin në PRTR. Protokolli radhit në Nenet 12, mbi Konfidencialitetin, rastet kur autoriteti publik mund të autorizohet të mbajë konfidencial informacionin e ruajtur në regjistër. Këto duhet të interpretohen gjithashtu në mënyrë të kufizuar, ku zbulimi i informacionit do të ndikonte negativisht në disa interesa të mbrojtura ligjërisht, për shembull: marrëdhëniet ndërkombëtare, mbrojtjen kombëtare, sigurinë publike, rrjedhën e drejtësisë, konfidencialitetin e informacionit komercial dhe industrial, të drejtat e pronësisë intelektuale, ose konfidencialitetin e të dhënave personale. Po ashtu, në mënyrë të ngjashme me Konventën e Aarhusit, autoriteti publik duhet të interpretojë bazat për pretendimin për konfidencialitet në mënyrë të kufizuar, duke marrë në konsideratë interesin publik të shërbyer nga zbulimi i informacionit, dhe nëse informacioni lidhet me shkarkimet në mjedis. Nëse informacioni mbahet konfidencial, duhet të shënohet në regjistër lloji i informacionit që është mbyllur, dhe për çfarë arsyesh. Nëse emri i një ndotësi specifik nuk bëhet i ditur, për shembull, nëse është e mundur, informacioni për përbërjen gjenerike kimike duhet të jepet, (pra, grupi i kimikateve në të cilën bën pjesë). Në rast të pretendimeve për konfidencialitet, publiku ka të drejtë të sfidojë vendimin e autoritetit publik në një procedurë rishikimi para një gjykate, ose një organi tjetër i pavarur dhe i paanshëm, të krijuar nga ligji (p.sh. një autoritet administrativ i lartë, një Ombudsman ose një Komisioner Special për Informacionin, etj.).

Publiku dhe OJF-të mund të përdorin mundësitë për pjesëmarrje publike të cilat duhet të sigurohen sipas Protokollit (Neni 13) në zhvillimin e PRTR-ve kombëtare ose kur planifikohen ndryshime të rëndësishme në regjistrat: akses i lirë në informacion për masat e planifikuara dhe duhet të sigurohen mundësi të përshtatshme për dorëzimin e komenteve, informacionit, analizave ose opinionit të rëndësishëm për procesin e vendimmarrjes, të cilat duhet të merren në konsideratë nga autoriteti publik.

Informacioni i PRTR mund të ndihmojë në ndërgjegjësimin e publikut për burimet e ndotjes dhe ndikimin e tyre në mjedis, duke nxitur një angazhim më të madh për mbrojtjen e mjedisit. Të dhënat e PRTR mund të ndikojnë në zhvillimin e politikave mjedisore duke ofruar një bazë faktike për hartimin e politikave dhe rregulloreve më të mira për mbrojtjen e mjedisit. PRTR mund të përdoret për të monitoruar efikasitetin e masave të ndërmarra për të ulur ndotjen mjedisore dhe për të vlerësuar progresin dhe nevojën për masa shtesëse. Ato gjithashtu mund të mobilizojnë pjesëmarrjen e publikut në proceset vendimmarrëse për mjedisin dhe të lejojnë qytetarët të kenë një rol më aktiv në hartimin dhe zbatimin e politikave mjedisore.

Gjatë periudhës 2022-2024, projekti "*Enhancement of Pollutant Release and Transfer Registers (PRTRs) in the Ëestern Balkan Countries and the Republic of Moldova*", ka organizuar një sërë aktivitetesh për të njohur organizatat e shoqërisë civile aktive për cështjet mjedisore në Kosovë me mundësinë e përdorimit të informacionit në RSHTN lidhur me ndotjen sipas rajoneve ku ndodhen. Këto aktivite kanë përfshirë trajnime tematike mbi mënyrën e grumbullimit të të dhënave, procedurën e raportimit prej operatorëve, mundësinë e aksesit për të dhënat.

Shkëmbimi i përvojës me organizata aktive në rajon mundësoi njohjen e rasteve konkrete ku të dhënat prej RSHTN kanë ndihmuar në organisimin e fushtave të advokimit dhe veprimiet konkrete me komunitetin.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të organizatave të shoqërise civile në forumet e aktorëve, së bashku me institucionet përgjegjëse për RSHTN dhe operatorët industrialë ndihmoi në një vendosjen e lidhjeve të drejtpërdrejta të komunikimit dhe bashkëpunimit për të ardhmen.

Dialogu i vazhdueshëm dhe komunikimi efektiv janë mjete që sigurojnë bashkëpunimin për të mirën e përbashkët: mjedis cilësor për komunitetin!





5.1. Avokimi mjedisor kundër ndotjes dhe veprimi i komunitetit

Shoqëria civile mund të përdorë të dhënat e PRTR si argumente për të bërë avokim masiv për të ulur ndotjen në nivelet e pranueshme, për ndërgjegjësim të pubikut, si dhe për lobim për investime në teknikat më të mira në dispozicion për ruajtjen e mjedisit.

Me gjithë mungesën e PRTR-së, organizatat jofitimprurëse në Kosovë kanë arritur të mbledhin të dhëna për ndotjen mjedisore nga operatorët e veçantë, kanë avokuar tek autoritetet për të zvogëluar ndotjen nga operatorë të ndryshëm, dhe kanë ndërmarrë veprime për të promovuar një mjedis më të pastër.

'Ditët e Energjisë së Gjelbër 2022'

'Ditët e Energjisë së Gjelbër' ishte një nismë në kuadër të projektit "Evropianizimi i agjendës mjedisore të Kosovës", i cili u financua nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe u zbatua nga BIRN Kosova, CEE Bankwatch, ERA-Group dhe TV Mrezha. 'Ditët e Energjisë së Gjelbër' synuan të nxjerrin në pah sa me rëndësi është efiçienca e energjisë, mbrojtja e mjedisit dhe shëndeti publik, veçanërisht për zyrtarët përkatës. BIRN Kosova filloi nismën e me publikimin e një video dokumentari "Helm n'ujë, Helm n'ajër". ERA-Group organizoi dy takime dialogu me të rinjtë për mbrojtjen e mjedisit, ku morën pjesë 109 të rinj nga komunat e Pejës dhe Gjakovës. Seancat promovuan praktikat e mira mjedisore dhe mjetet advokuese që synonin adresimin e çështjeve urgjente mjedisore. Një nga aktivitetet kryesore të 'Ditëve të Energjisë së Gjelbër 2022' ishte organizimi i një konference të nivelit të lartë.

Me tre panele diskutimi, konferenca bëri bashkë udhëheqës të lartë dhe vendimmarrës nga e gjithë Kosova dhe rajoni për të diskutuar të ardhmen e energjisë së gjelbër në Ballkanin Perëndimor, si dhe sfidat e dekarbonizimit. Në konferencë u prezantua gjithashtu një dokument i ri i pozicionit mbi Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës për Kosovën, i cili përfshinte 32 rekomandime konkrete se si mund të lëvizë vendi drejt një ekonomie me efiçiencë të energjisë dhe me burime të energjisë në shkallë 100 për qind. Një analizë mbi ndotjen e ujërave dhe lumenjve dhe një material me interes të përgjithshëm publik mbi ndotjen e ujit në lumin Drini i Bardhë u publikuan gjatë 'Ditëve të Energjisë së Gjelbër 2022'.

ERA-Group mbylli 'Ditët e Energjisë së Gjelbër 2022' duke organizuar një aktivitet, mobilizimin rinor me 30 të rinj nga komuna e Pejës. Përmes këtij aktiviteti, pjesëmarrësit patën mundësinë të mbjellin pisha në kopshtin e shkollës së tyre, duke gjelbëruar hapësirën publike dhe duke promovuar aksionin kolektiv mes brezave të rinj.

Në veçanti, organizatat jofitimprurëse në Kosovë kanë qenë shumë të zëshme kundër ndotjes nga prodhimi i energjisë nga linjiti dhe plani për ndërtimin e kapaciteteve të reja termoenergjetike të bazuara ekskluzivisht në linjit, si dhe dhe kanë promovuar investime në burime alternative të energjisë siç është energjia e ripërtrishme.

Disa shoqata në Kosovë kanë organizuar protesta dhe fushata të ndryshme për të nxitur qeverinë dhe sektorin privat të përdorin më shumë burime të energjisë së ripërtërishme, dhe të ndalojnë përdorimin e energjisë së fituar nga qymyri. Këto fushata kanë përfshirë thirrje për politika më të rrepta kundër ndotjes së mjedisit nga prodhimi i energjisë tradicionale, si dhe për të promovuar investime në projekte të energjisë së ripërtrishme siç janë parqet solare, energjia nga era dhe hidrocentralet e vogla. Shoqatat kanë organizuar edhe takime, konferenca dhe punëtori për të sensibilizuar publikun dhe për të nxitur bashkëpunimin mes aktorëve të ndryshëm për të arritur qëllimet e tyre për një mjedis më të pastër dhe një sistem energjie më të

qëndrueshëm. Gjithashtu, ato kanë publikuar një numër të fletushkave, videove dhe raporteve me informata dhe të dhëna të konsiderueshme për ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës, si dhe efekteve në shëndet të popullates nga gjenerimi i energjisë nga dy termoelektranat e Kosovës të cilat kanë arritur t'i mbledhin nga burime të ndryshme siç janë raportet zyrtare të AMMK-së, si dhe hulumtimet e organizatave ndërkombëtare si Banka Botrore, Carl Bro, etj.

Kështu, OJf-të mjedisore kanë luajtur një rol të rëndësishëm në nxitjen e ndërgjegjësimit për çështjet e mjedisit dhe energjisë në Kosovë dhe kanë lobuar për politika më të mira të mjedisit dhe energjisë së qëndrueshme.

5.2 Kontributi në përmirësimin e sistemit vlerësues të ndotjes dhe monitories mjedisor

Organizatat e shoqërisë civile kanë rol të rëndësishëm në përmirësimin e sistemeve të vlerësimit të impaktit të ndotjes dhe monitorimit mjedisor. Ndikimi i tyre është në nivele të ndryshme, duke filluar nga monitorimi i pavarur i ndotjes së mjedisit dhe impaktit të projekteve të ndryshme në mjedis.

Shoqatat jo-fitimprurëse janë:

- Zëra të fuqishëm për të ngritur ndërgjegjësimin për çështjet mjedisore dhe për të lobuar për politika më të mira mjedisore në nivel lokal dhe ndërkombëtar;

- Monitorues të zbatimit të politikave publike, duke identifikuar çështje dhe duke propozuar zgjidhje;

- Mobilizues të komunitetit në proceset e vendimmarrjes në lidhje me mjedisin duke siguruar që zëri i tyre të dëgjohet;

- Përpilues të projekteve pilotuese dhe inovative që tregojnë mënyra të reja për të menaxhuar dhe mbrojtur mjedisin.

Organizatat e shoqërisë civile kanë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e sistemeve të vlerësimit dhe monitorimit mjedisor. Këto organizata mund të ndikojnë në monitorimin e pavarur të ndikimit mjedisor të projekteve të ndryshme, duke ofruar një perspektivë objektive dhe të pavarur. Përveç kësaj, ato ndihmojnë në ndërgjegjësimin e publikut dhe ngritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me çështjet mjedisore, duke promovuar sjellje dhe praktika më të qëndrueshme.

organizatat e shoqërisë civile gjithashtu mund të lobojnë në favor të politikave dhe legjislacionit që promovojnë mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e sistemeve të vlerësimit dhe monitorimit mjedisor. Ato gjithashtu e monitorojnë edhe zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve mjedisore, duke identifikuar dhe raportuar shkeljet e mundshme.

Përveç kësaj, organizatat e shoqërisë civile mund të ndihmojnë në hulumtime dhe në zhvillimin e kapaciteteve në fushën e vlerësimit dhe monitorimit mjedisor duke ndihmuar në përmirësimin e praktikave dhe metodologjive të përdorura. Kontributi i tyre është jetik për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe mbrojtje të mjedisit në të ardhmen.

PRTR mund të luajë një rol kyç në përmirësimin e vlerësimit të ndotjes dhe sistemit të monitorimit mjedisor. Përmes përdorimit të informacionit të PRTR, institucionet mjedisore dhe shoqëria civile mund të kenë një panoramë të qartë të burimeve dhe niveleve të ndotjes. Ky informacion mund të përdoret për të zhvilluar strategji efektive për reduktimin e ndotjes dhe për të monitoruar zbatimin e lejeve mjedisore. Kur informacioni nga PRTR të jetë i disponueshëm, ai mund të shërbejë si bazë për të ndjekur dhe monitoruar zbatimin e rregulloreve mjedisore, duke siguruar që aktivitetet industriale dhe të tjera të jenë në përputhje me standardet e përcaktuara. Në këtë mënyrë, PRTR kontribuon në përmirësimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë, duke rritur besimin e publikut në proceset e vendimmarrjes dhe mbrojtjen e mjedisit.

Rast studimor: Organizatat e shoqërisë civile përdorin të dhënat e RSHTN-së

Qyteti industrial i Zenicës, në Bosnje dhe Hercegovinë, përballet me nivele të larta të ndotjes së arjit si pasojë e veprimtarisë së uzinës metalurgjike ArcelorMittal. Shoqata lokale "Eko Forum Zenica" u përpoq të mblidhte informacion për cilësinë e ajrit dhe shkarkimet e kompanisë ArcelorMittal për të përcaktuar se nga buronte kjo ndotje. Ata ju drejtuan autoritetit mjedisor me disa kërkesa për informacion lidhur me shkallën e shkarkimeve, vëllimin e prodhimit, si dhe sasinë e squfurit në qymyr.

Shoqata EFZ analizoi burimet dhe shkaqet reale të ndotjes dhe organizoi një fushatë publike kundër këtij ndotësi. Kompania operonte pa leje mjedisore prej disa vitesh radhazi, edhe pse ishte e detyruar të pajisje me lejet përkatëse deri në fund të vitit 2008. Më tej, shoqata EFZ mori pjesë në dëgjesat publike lidhur me procedurat e lëshimit të lejeve mjedisore përgjatë vitit 2009, ku paraqiti të dhënat e mbledhura për shkarkimet, si dhe pasqyroi komentet e saj në të gjitha dokumentet për shqyrtim. Pavarësisht këtij presioni, kompania sërish përfitoi një shtyrje deri në vitin 2011, teksa vazhdoi të shkarkonte tonelata me pluhur dhe kimikate nga uzinat e saj. Ishin nivelet shumë të larta të ndotjes që i detyruan njerëzit të dilnin në demonstrata. Më shumë se dhjetë mijë qytetarë u mblodhën në qendër të qytetit dhe marshuan drejt selisë së ArcelorMittal në dhjetor të vitit 2012. Ata kërkuan që të respektoheshin të njëjtat rregulla të zbatuara në vendet e Bashkimit Evropian, sikurse dhe kompania kishte premtuar fillimisht.
Në dhjetor të vitit 2014, kur 5 nga 9 lejet mjedisore të ArcelorMittal skadonin, ndërkohë që as Ministria e Mjedisit dhe as Inspektorati i Mjedisit nuk morën masa, "Eko Forum Zenica" dhe komunitetet vendase ngritën kallëzim penal ndaj kompanisë për ndotje mjedisore, si dhe ndaj zyrtarëve, për shpërdorim detyre. Në fund të vitit 2015, Ministria e Mjedisit rinovoi lejen mjedisore vetëm për një impiant, por edhe ajo leje u



kundërshtua në gjykatë, pasi publiku nuk ishte përfshirë në konsultime gjatë procesit të rinovimit. Në fillim të vitit 2016, kur skadonin të gjitha licencat e mbetura, kompania aplikoi për një licencë të re për të gjitha impiantet së bashku. Por kësaj here, Ministria e Mjedisit përfshiu në procedurën e vlerësimit të kërkesës përfaqësues të qytetit dhe të "Eko Forum Zenica". EFZ ngriti edhe çështjen e përgjegjësisë penale të zyrtarëve për mosveprim karshi kompetencave të tyre, ndërsa disa viktima të prekura nga ndotja ngritën edhe kallëzime penale. Edhe pse ArcelorMittal në Zenicë është larg standardeve të BE-së, përpjekjet e përbashkëta të qytetarëve dhe shoqërisë civile përmes dëgjesave dhe betejave ligjore dhanë rezultat dhe ngjallën shpresën se cilësia e ajrit në Zenicë mund të përmirësohet në të ardhmen. Nismat ligjore mund ta detyrojnë kompaninë e fuqishme të fillojë të kujdeset për ndikimin mjedisor të operacioneve të saj.

Protestat masive bënë të dukshme ndërkombëtarisht ndotjen tragjike në Zenicë. Duke qenë se autoritetet shtetërore kanë qenë neglizhente prej vitesh, banorët vendas ndoqën një sërë strategjish të kombinuara, sikurse ishin paditë e posaçme të individëve të prekur, kallëzimet penale kundër zyrtarëve shtetërorë, si dhe pjesëmarrja në të gjitha dëgjesat publike dhe procedurat vendimmarrëse, për ta adresuar më tej çështjen. Një presion i tillë shoqëror dhe ligjor mund ta detyrojë një kompani kaq të fuqishme të fillojë të kujdeset për ndikimin mjedisor të operacioneve të saj.



Pikërisht, qëllimi kryesor i një RSHTN-je është t'i japë publikut mundësinë për t'u informuar rreth burimeve të ndotjes. OJQ-të duhet të kenë akses në informacione të tilla për të ditur se ku t'i drejtojnë përpjekjet dhe veprimtaritë e tyre, cilat janë burimet kryesore të ndotjes dhe se cila është përbërja e substancave ndotëse.

Kësisoj, shoqata "Eko Forum Zenica" përdori të dhënat e RSHTN-së për disa nga aktivitetet e saj, ndër të cilat:
- Verifikimin e informacionit dhe përcaktimin e masave të reja për lëshimin e lejeve mjedisore;
- Ndihmën për qeverinë që të planifikojë dhe veprojë ndaj ndotësve;
- Krijimin e një regjistri alternative, të bazuar në të dhënat e nxjerra nga autoritetet përmes kërkesave për informacion drejtuar këtyre të fundit: https://eko.ba/baza-zagadivaca
- Zbulimin e pikave më të nxehta dhe paraqitjen e tyre përmes një harte interaktive: https://eko.ba/hotspots
- Publikimin e të dhënave lidhur me dhjetë ndotësit kryesorë në vend;
- Gjurmimin e të metave në raportimin e bërë nga operatorët, si dhe të të dhënave që mungojnë.

Burimi: https://eko.ba/hotspots/42-zeljezara-arcelor-mittal; prezantime të z. Samir Lemeš, Eko Forum Zenica, në takimet dhe trajnimet e organizuara në kuadër të projektit "*Enhancement of Pollutant Release and Transfer Registers (PRTRs) in the Western Balkan countries and the Republic of Moldovd*".

6. Burimet e informacionit

LIGJI NR. 06 L-081: Për qasje në dokumente publike

LIGJI NR. 08 L-145: Për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes

LIGJI NR. 03 L-025" Për mbrojtjen e mjedisit

Broshurë për Qasje në Dokumente Zyrtare

Forum (2015): Një Përrallë Moderne, Kosova C 2100MW

GAP (2017): Roli dhe Rëndësia e Qytetarisë Aktive

GIZ (2013): Përmbledhje legjislacioni për të drejtën e qasjes në dokumente publike

KEC (2019): Pjesëmarrja dhe ndikimi i organizatave të shoqërisë civile në proceset e politikë-bërjes dhe vendimmarrjes në Kosovë

REC (2006): Konventa "Aarhus" Kuptimi, rëndësia dhe aspekte të zbatimit të saj në praktikë,

Secretariat of the Aarhus Convention, UNECE: Note on Civil Society Space

https://www.balkangreenfoundation.org/en-us/publications/

https://www.kosid.eu.com/

https://indep.info/publikimet-2/

https://uca.ldipeja.org/

https://birn.eu.com/news-and-events/green-energy-days-2022-comes-to-an-end/

https://kigngo.com/

Burimet të rëndësishme

Protokolli i PRTR dhe Portali Europian i Shkarkimeve Industriale
https://industry.eea.europa.eu/

Faqja e Internetit të Protokollit PRTR
https://unece.org/env/pp/protocol-on-prtrs-introduction

Udhëzuesi i thjeshtëzuar i Protokollit PRTR
https://unece.org/environment-policy/publications/simplified-guide-protocol-pollutant-release-and-transfer-registers

Portali Global i PRTR

https://prtr.unece.org/

Faqja e Internetit të Konventës së Aarhusit
https://unece.org/environmental-policy-1/public-participation